



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 11  
Prishtinë, më 06 maj 2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**  
**i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mimoza Ahmetaj, Flora Brovina, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj dhe Teuta Hadri.

Munguan: Gjylnaze Syla, Qamile Morina, Slobodan Petroviq, dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Drita Morina - zyrtare e lart ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit  
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Shqyrtimi i punës së Komisionit deri me tani dhe planifikimi i punëve në vijim ;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa plotësime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje .

### **3. Shqyrtimi i punës së Komisionit deri me tani dhe planifikimi i punëve në vijim ;**

**Kryetari** – Tha se vizitën që e kemi planifikuar ne javën e kaluar nuk u realizua për shkak të seancës tani na mbetet për javën e ardhshme mendoj ta vizitojmë qendrën rehabilituese në Deçan ose në Kamenicë .

**Teuta Hadri** – Propozoj që të vizitohet qendra e Shtimes pasi është qendra kryesor dhe është nën menaxhimin e MPMS dhe të shikohet sa Qeveria jonë kujdeset për këtë kategori.

**Armend Zemaj** – Propozoj që të vizitohet Qendra rehabilituese në Deçan pasi është një qendër që posa është hapur dhe do të jetë një përkrahje dhe inkurajim për punën e kësaj qendre.

**Kryetari** – Propozoj që jave e ardhshme të martën Komisioni ta vizitoj Institutin e Shtimes ndërsa pas përgatitjeve të duhura në fund të muajit maj Komisioni do ta vizitojmë edhe qendrën rehabilituese në Deçan .

Çështje tjetër që do të trajtohet këtë muaj është edhe P/Ligji për ushqimin . Komisioni i Bujqësisë ju ka drejtuar me një shkresë Qeveris së Kosovës ku kërkon mendimin e Qeveris lidhur me Agjencionin e Ushqimit dhe ne presim përgjigjen e Qeveris pastaj do ta shqyrtojmë këtë P/Ligj .

**Flora Brovina** – Propozon që edhe ky Komisioni j ti drejtohet me një shkresë Qeveris lidhur me Agjencionin e Ushqimit.

**Armend Zemaj** – Tha se pasi Komisioni ynë nuk ka shqyrtuar këtë P/Ligj , Komisioni i Bujqësisë nuk është dashtë që në shkresën drejtuar Qeveris ta jap mendimin edhe në emër të Komisionit tonë.

**Kryetari** - Tha se nëse Qeveria merr ndonjë qëndrim ai qëndrim do të jetë i pranueshëm edhe për Komisionin tonë. Qëndrimi i Komisionit të Shëndetësisë edhe i mandatit të kaluar por edhe në këtë mandat është që Agjencionin e Ushqimit të mos jetë në kuadër të MBPZHR por të jetë në kuadër të Zyrës së kryeministrit.

**Flora Brovina** - Tha se në mandatin e kaluar ne kemi kundërshtuar që Agjencionin të jetë në kuadër të MBPZHR sepse një sektor i rëndësishëm i MSH që është Inspeksioni Sanitar kalon në këtë Agjencion . Insistimi i Komisionit të bujqësisë ka qenë që ky Agjencion të jetë pran MBPZHR. Qeveria nuk e din qëndrimin e Komisionit tonë , ndërsa në mandatin e kaluar ne patëm marr një shkresë që kryeministri ishte pajtuar që ky Agjencion të jetë në kuadër të Qeveris por ne prapë edhe pas kësaj shkrese të kryeministrit nuk arritëm të harmonizojmë qëndrimet me Komisionin e Bujqësisë.

**Teuta Hadri** – Tha se Komisioni i mandatit të kaluar ka kundërshtuar që ky Agjencion të jetë në kuadër të MBPZHR sepse pacientët e infektuar vinin për shërim në qendrat shëndetësore e jo në Ministrinë e Bujqësisë. Qëndrimi jonë atëherë ka qenë që ky Agjencion të jetë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë por nuk e di pse nuk u përkrah ky qëndrim nga Ministria e atëherëshme e Shëndetësisë.

Tani jam kategorike që ky Agjencion të jetë në kuadër të Qeveris .

**Mimoza Ahmetaj** - Tha se me trendët më të reja botërore në shtete e zhvilluara ku Agjencion i Ushqimit i takon Ministrisë së Bujqësisë. Ky Agjencion merret me ushqimin që nga mbjellja e deri ne produktin final . Është dashtë që Kosova ti ketë laboratorët më të avancuara për Kontrollin e ushqimit. Pasi mendojmë që të jemi pjesë e Evropës ky Agjencion duhet të jetë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe të ndërpritet një herë e përgjithmonë konflikti.

**Armend Zemaj** - Tha se për mua ka qenë e rëndësishme që pa marr parasysh konfliktin e kompetencave, ky ligj është dashtë të miratohet në mandatin e kaluar sepse është një ligj shumë i rëndësishëm për Kosovën. Ne duhet si Komision të sjellim një qëndrim dhe ti rekomandojmë Qeveris se pajtohem që Agjencioni i Ushqimit të jetë në kuadër të Qeveris ose të propozojmë një amendament në P/Ligj lidhur me këtë Agjencion.

**Kryetari** - Tha se propozuese e këtij P/Ligji ka qenë Ministria e Bujqësisë , por pjesë e këtij Agjencioni do të jetë edhe Inspeksioni sanitar të cilët nuk do të pranojnë të jenë pjesë e Ministrisë së Bujqësisë. Pas këtij konflikti të kompetencave unë edhe në mandatin e kaluar edhe tani kam qenë kundër që ky Agjencion të jetë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë por kam propozuar që ky të jetë në kuadër të Qeveris dhe bordi të jetë i formuar nga Qeveria . Ne kur të marrim përgjigjen nga Qeveria atëherë si Komision do të dalim me qëndrimin tonë ose do të kemi një mbledhje të përbashkët me Komisionin e Bujqësisë.

**Flora Brovina** - Tha se në mandatin e kaluar kemi marrë përgjigjen me shkrim nga Qeveria lidhur me këtë Agjencion por prapë me Komisionin e Bujqësisë nuk kemi mundur të dakordohemi. Ky ligj është mjaft i rëndësishëm dhe duhet përshtatur edhe nevojave të Kosovës sepse ne jemi më shumë importues sesa prodhues.

**Nurishahe Hulaj** - Tha se esenciale është që ky Agjencion të jetë Agjencion me mbikëqyrje qeveritare për shkak të rëndësisë që ka. Propozoj që ti drejtohem me një shkresë Qeveris dhe të kërkojmë mendimin e tyre dhe nëse Qeveria nuk vendos atëherë ne do të dalim me amendament konkret dhe do të votohet në Kuvend.

**Kryetari** - Tha se unë as në mandatin e kaluar nuk e kam përkrah dhe nuk do ta përkrah as tani që ky Agjencion të jetë në MBZHR. Do ta përkrah që ky Agjencion të jetë në kuadër të Qeveris .

**Rita Hajzeraj** - Tha se pasi kemi mospajtime, propozoj që të takohemi me Komisionin e Bujqësisë dhe ta shqyrtojmë këtë çështje. Ne si deputet të mandatit të ri nuk e dimë rrjedhën e mandatit të kaluar lidhur me këtë P/Ligj dhe dëshirojmë të kemi më shumë informata se në kuadër të kujt duhet të jetë ky Agjencion.

**Nurishahe Hulaj** - Tha se 50% e rasteve të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë janë si pasoj e kontaminimit të ushqimit dhe është një indikator shumë i rëndësishëm që e jep rëndësinë që Agjencion i ushqimit të jetë nën mbikëqyrje Qeveritare.

**Kryetari** - Tha se shëf i këtij Agjencioni nuk mund të jetë një veterinar, për këtë arsye ky Agjencion nuk duhet të jetë kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë. Sponsorues i Ligjit ka qenë Ministria e Bujqësisë dhe Agjencionin e Ushqimit e ka lëmë në kompetencë të kësaj Ministrie, ndërsa ne si Ministri e Shëndetësisë në mandatin e kaluar nuk jemi pajtuar. Disa vende të zhvilluara e kanë këtë Agjencion në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë por ne nuk jemi shtet i zhvilluar dhe kemi shumë probleme me ushqimin sepse më shumë jemi shtet që importojmë sesa që prodhojmë.

Do ta presim mendimin e Qeveris se a do të jetë Agjencioni në kuadër të Qeveris , nëse jo, ne si Komision do të dalim me qëndrimin tonë para Parlamentit.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë :

#### Përfundim

**Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kërkon nga Qeveria e Kosovës të jap qëndrimin rreth Agjencioni për Ushqim . Qëndrimi i Komisionit është që Agjencioni i Ushqimit të jetë në kuadër të Qeveris së Kosovës .**

**Kryetari** - Lidhur me këtë pik njoftoj anëtarët lidhur me ligjin për punën i cili së shpejti do të vjen në Parlament dhe Komisioni do ta shqyrtoj edhe para leximit të parë. Pas leximit të parë do të mbahet edhe dëgjim publik dhe do të angazhen edhe ekspert lidhur me këtë P/Ligj. Sa i përket vizitës në Institutin e Shtimes do të realizohet javën që vjen.

#### **Të ndryshme**

Për këtë pikë Komisioni diskutoj rreth realizimit të një vizite në ndonjë shtet jashtë Kosovës. Gjithashtu lidhur me raportimin para Kuvendit, për qëndrimet e Komisionit të dalë vetëm Kryetari apo raportuesi e jo në emër të Komisionit të dal ndonjë anëtar i Komisionit dhe të thotë diçka që nuk është qëndrim i Komisionit

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 12:10

Përgatitur nga  
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

*Kryetari i Komisionit,*

*Sadik Idriz*